



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

KALENDARI I SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR
PËR VITIN 2010

Përgatitur nga: Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj,
Ministria e Financave dhe Ministria e Integritimit Europian

Shkurt 2010

TABELA E LËNDËS

HYRJE	3
STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM [SKZHI]	4
INTEGRIMI EVROPIAN.....	6
PROGRAMI BUXHETOR AFATMESEM [PBA].....	10
NDIHMA E HUAJ	12
SHTOJCA 1: VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I PROCESEVE	15
SHTOJCA 2: KALENDARI I TAKIMEVE TË GSP-ve.....	22

AKRONIMET E PËRDORURA NË TEKST

AA	Agjencia e Auditit
AFCOS	Shërbimi operacional i pavarur për koordinimin kundër-korrupsionit
AT	Asistencë Teknike
CAO-NAO	Zyrtari Kompetent Akreditues -Zyrtari Autorizues Kombëtar
DEBASKON	Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj
DShIP	Dokumenti Shumëvjeçar Indikativ i Planifikimit
FK	Fondi Kombëtar
FTI-DoL	Iniciatiava Fast-Track mbi ndarjen e punës
GSBI	Grupi i Punës për Strategji, Buxhet dhe Integrim
IPA	Instrumenti i Para-Aderimit
KM	Këshilli i Ministrave
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integritit European
MIP	Menaxhimi i Investimeve Publike
MIS	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit
MSHP	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
MVP	Matrica e Vlerësimit të Performancës
NjQFK	Njësia Qendrore e Financimit dhe Kontraktimit
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PIM	Plani i Integruar i Ministrisë
PMM	Plani i Monitorimit të Ministrisë
PShIP	Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit
RPP	Rishikimi i Politikës së Programit
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
SPO	Zyrtarë të Programimit Sektorial
VNF	Vlerësimi i Ndikimit Fiskal
VNP	Vlerësimi i Ndikimit të Politikave
VNR	Vlerësimi i Ndikimit Rregullator
WBIF	Fondi i Infrastrukturës për Ballkanin Perëndimor

HJRJE

Kalendari i Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) botohet çdo vit dhe përfshin të gjitha proceset dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me zbatimin e SPI-së. Komponentët kryesorë të SPI-së janë: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Integrimi European, Programi Buxhetor Afatmesëm dhe Ndihma e Huaj.

Kalendari i SPI-së 2010 përbëhet nga katër kapituj, një për çdo komponent, ku renditen proceset dhe jepet kalendari i aktiviteteve. Ndërsa përshkrimet e përgjithshme të të gjithë komponentëve të SPI-së si dhe përditësimi i tyre janë vendosur tek Shtojca 1. Ky ristrukturim i Kalendarit SPI 2010 është bërë me qëllim që fokusi të jetë tek kalendari i sejcilit proces për një bashkërendim më të mirë të tyre dhe funksionim më të mirë të SPI-së në tërësi. Kalendari i aktiviteteve të grupeve sektoriale është një risi që i është shtuar këtij dokumenti në shtojcën 2.

Kalendari i Sistemit të Planifikimit të Integruar për vitin 2010 menaxhohet nga koordinatorët e caktuar për këtë dhe përkatësisht Alma Gërxhani (agerxhani@km.gov.al) në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, Vilma Causholli (vcausholli@minfin.gov.al) në Ministrinë e Financave dhe Patris Kraja (patris.kraja@mie.gov.al) në Ministrinë e Integritit European. Në ministritë e linjës koordinatore për kalendarin e SPI-së janë Sekretarët e Përgjithshëm.

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM [SKZHI]

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013 (SKZHI) përfaqëson dokumentin strategjik themelor të vendit që harmonizon perspektivën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, integrimin në strukturat e Bashkimit Evropian dhe të NATO-s, si dhe arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit. Miratuar në mars të vitit 2008, SKZHI përmbledh 21 strategji sektoriale dhe 17 strategji ndërsektoriale, procesi i hartimit të cilave pothuaj ka mbaruar. Gjatë vitit 2010 dhe vitet në vazhdim vëmendja për SKZHI-në do të përqendrohet në zbatimin e strategjive, monitorimin dhe raportimin, si procesi kryesor i planifikimit të politikave dhe planifikimit financiar.

Proceset dhe produktet kryesore të SKZHI-së

1. Politikat Prioritare
 - a. Përcaktimi i politikave dhe projekteve prioritare për PBA 2011-2013
2. Plani i Integruar i Ministrisë 2010
 - a. Plani i Monitorimit të Ministrisë (2010)
3. Raporti Vjetor mbi Rezultatet (2009)
4. Raporti Vjetor i Progresit për vitin 2009
5. Monitorimi i strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale
6. Vlerësimi i Ndikimit të Politikave

KALENDARI PËR SKZHI-në PËR VITIN 2010

1. Politikat Prioritare

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Janar	15	DEBASKON ML	Ministritë dërgojnë zyrtarisht politikat e tyre prioritare për PBA 2011-2013
Janar	27	KPS	KPS miraton politikat prioritare më të rëndësishme për t'u përfshirë në tavanet buxhetore të PBA 2011-2013

2. Plani i Integruar i Ministrisë (PIM)

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Dhjetor 2009	1-8	DEBASKON	Përgatit strukturën dhe udhëzimet e PIM-eve 2010 dhe i dërgon te Ministritë e Linjës
	30	DEBASKON ML	Negociohen indikatorët që do raportohen në Planet e Monitorimit të Ministrive 2010
Janar 2010	15	ML	Ministritë sjellin PIM-et 2010 të plotësuar
Mars 2010	10	DEBASKON	Finalizon PIM-et 2010
	25	DEBASKON ML	Publikohen PIM-et 2010

3. Raporti Vjetor i Rezultateve të Ministrisë (RVRM)

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Shkurt	10	DEBASKON	Përgatit strukturën dhe udhëzimet e RVRM 2009 dhe i dërgon te Ministritë e Linjës
Mars	10	ML	Ministritë sjellin RVRM 2009 të plotësuar
	25	DEBASKON	Rishikohen RVRM 2009
	30	DEBASKON ML	Finalizohet dhe publikohen RVRM 2009

4. Raporti Vjetor për Progresin e SKZHI-së 2009

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Shkurt	16	DEBASKON	Shpërndahen udhëzimet për kontributin e ministrive në Raportin për Progresin për vitin 2009
Mars	19	ML, institucionet	Dërgohet kontributi nga institucionet e përzgjedhura
Prill	29	DEBASKON	Rishikohet, integrohet raportimi për ndihmën e huaj dhe dërgohet për komente Raporti i Progresit 2009, tek institucionet dhe donatorët
Maj	29	DEBASKON	Finalizohet Raporti vjetor i Progresit 2009
Qershor	30	DEBASKON	Botohet raporti sintezë SKZHI-së dhe ndihmës së huaj

5. Monitorimi i strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Shkurt		DEBASKON/ML	Propozohen tregues të rinj për monitrimin e strategjive përcaktohet MVP ² (Matrica e Vlerësimit të Performancës) pasi aplikohet në dy sektorë pilot
Mars-Prill ndiqet axhenda PBA 2011-2013		DEBASKON/ML MF	Përkthim i treguesve të rinj në PBA, përcaktohet njësia bazë e matjes së këtyre treguesve, përfshihen procedurat e MVP në kalendarin e SPI-së
Mars		DEBASKON	MVP prezantohet tek ML-të, trajnime në LM që të përgatisin treguesit e tyre MVP
Maj		DEBASKON/MF	Format i ri i raportit të progresit prezantohet për monitorimin tremujor të PBA-së dhe përfshin një kapitull për monitorimin e PIM
Korrik		DEBASKON	Raport progreset gjashtëmujore mbi strategjinë sektoriale kundrejt MVP dërgohen në KPS

6. Vlerësimi i Ndikimit të Politikave

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Shkurt-Mars		DEBASKON Dept Ligjor KM	Diskutohen dhe zhvillohen modele të ndryshme mbi vlerësimin e ndikimit të politikave në bashkëpunim me MF, MEI dhe institucione të tjera. Finalizimi i modelit të Vlerësimit të Ndikimit të Politikave
Mars		DEBASKON, MF, ML	Tryeza të rrumbullakëta me MF, DEBASKON, ministrinë, se si të zbatojnë modelin e VNP-së. Trajnime për MF, MIE, dhe ministrinë pilot për VNP-në
Prill		DEBASKON	Dorëzimi i propozimit formal të VNP-sv në KMQ/KPS për miratim
Maj-Qershor		DEBASKON, ML	Lançimi i dy manualëve "How to do" për DEBASKON dhe ML mbi përgatitjet e VNP-së dhe vlerësimin e procesit
Korrik		DEBASKON, ML	Trajnime me ML-të për zhvillimin dhe përmirësimin e aftësive të stafit të ML për të bërë analizë politikash; pilotimi I PNV-së në disa LM.
Shtator		DEBASKON, LM	Përgatitja e një materiali të shkurtër për rishikim nga ministrinë mbi vlerësimin e PNV-së të zbatuar në dy ministri pilot.
Shtator		DEBASKON, Dept Ligjor	Diskutim me Dept Ligjor në zyrën e KM dhe me Ministrinë e Financave në lidhje me instrumentet ligjore që nevojiten për zbatimin e PNV-së. Draft rishikim akteve nëligjore.

¹ Raporti vjetor i Progresit të SKZHI-së dhe i Nihmës së Huaj do të integrohen në një dokument të vetëm që do të përbëjë Raportin e Progresit 2009.

² PAM- Performance Assessment Matrix

INTEGRIMI EVROPIAN

Integrimi European është synimi madhor i Qeverisë Shqiptare e cila do të vazhdojë të mbetet e angazhuar plotësisht në zbatimin e axhendës së saj Evropiane, si një prioritet i politikës së jashtme, veçanërisht gjatë vitit 2010. Të gjitha përpjekjet e përqendruara në kuadër të zbatimit të SPI-së po prodhojnë rezultatet e para pozitive të pasqyruara në një reflektim më të mirë të iniciativave për Integrim Evropian.

Datat e përcaktuara në kalendar mbi aktivitetet e lidhura me Integrimin European në disa raste janë vetëm indikative. Ato do të saktësohen rast pas rasti, në varësi të kalendarit të shërbimeve të KE-së për çështjet përkatëse.

Proceset dhe produktet kryesore që lidhen me Integrimin European janë:

1. Zbatimi i MSA-së:
 - a. Vlerësimi i zbatimit të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së
 - b. Reflektimi i prioriteteve të planit të zbatimit të MSA-së në procesin buxhetor dhe të PBA-së
 - c. Monitorimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së
 - d. Analiza e Dokumentit të Partneritetit European dhe raportit vjetor për progresin
 - e. Forcimi i strukturave të përbashkëta BE - Shqipëri, të ngritura me hyrjen në fuqi të MSA-së

2. Instrumenti i Para-aderimit (IPA)
 - a. Finalizimi i programimit IPA 2010
 - b. Programimi i IPA 2011
 - c. Programimi i Instrumentit të Përgatitjes së Projekteve të Investimit në Infrastrukturë (IPF) për vitin 2010
 - d. Decentralizimi

3. Fillimi i procesit të përkthimit të "acquis" në gjuhën shqipe
 - a. Çertifikimi i akteve të përkthyer
 - b. Përkthimi i akteve duke reflektuar prioritetet e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së
 - c. Standartizimi i përkthimit

Aplikimi për Statusin e Vendit Kandidat në BE

Muaji	Institucioni përgjegjës	Veprimi
16 Dhjetor 2009	KE, MIE	Dorëzimi i Pyetësorit për statusin e vendit kandidat dhe fillimi i punës për përgjigjet
16 Dhjetor-Shkurt 2010	MIE	Koordinimi i punës për hartimin e përgjigjeve nga institucionet shqiptare
Janar 2010	MIE	Përfundimi i procedurave të përzgjedhjes së përkthyesve për përkthimin e pyetësorit në gjuhën angleze
Shkurt 2010	MIE	Kontrolli i cilësisë së përgjigjeve dhe finalizimi i versionit zyrtar të përgjigjeve të Pyetësorit
Nëntor 2009-Mars 2010	MIE (me mbështetjen e SMEI)	Asistencë teknike (trainime, ekspertë të jashtëm) për ministritë dhe institucionet lidhur me çështjet që adreson Pyetësori
Mars 2010	MIE	Përkthimi i Përgjigjeve dhe dërgimi në KE

1A. Vlerësimi i zbatimit të "Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së" dhe rishikimi i prioriteteve

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Mars	1-7	MIE Ministritë e Linjës	MIE shpërndan udhëzimet dhe metodologjinë për rishikimin e PKZMSA-së. Ngrihen grupet ndërministrorë të punës që do të rishikojnë Planin Kombëtar. Vlerësohet zbatimi i detyrimeve të parashikuara për periudhën tetor 2009 - mars 2010 dhe analizohen shkaqet e mosrealizimit të angazhimeve të ndërmarra.
	15	Ministritë e Linjës	Rishikimi i afateve të realizimit të detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit
		Ministritë e Linjës	Rishikimi i përgjegjësive institucionale të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga MSA.
		Ministritë e Linjës	Rishikimi i prioritizimit të akteve legjislative të Bashkimit Evropian të cilat do të adoptohen në legjislacionin vendas.
	20	Ministritë e Linjës	Përshkrimi i projekteve për financim për çdo sektor
	25	MIE Ministritë e Linjës	Rivlerësim i iniciativave ligjore që do të ndërmerren nga institucionet shtetërore në PKZMSA
	25	MIE Ministritë e Linjës	Rivlerësim i aktiviteteve zbatuese që do të ndërmerren nga institucionet shtetërore në PKZMSA
Prill	1	MIE Ministritë e Linjës	Rivlerësim dhe ripërcaktim i kapaciteteve administrative të nevojshme, sipas fushave sektoriale
	7	MIE MF	Rivlerësim dhe ripërcaktim i kostove financiare në përputhje me Planin Buxhetor Afatmesëm, 2010-2012
		MIE	Përditësim i sistemit të bazës së të dhënave me synim monitorimin elektronik të PKZMSA-së nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore
		MIE Institucionet shtetërore	Korrespondenca në rrugë zyrtare ndërmjet MIE dhe institucioneve shtetërore për transferimin e të dhënave në sistemin e të dhënave bazë të PKZMSA-së. Dërgimi i shkresave finale për të përmbyllur dokumentin final.
		MIE	Përpunimi i të dhënave dhe përgatitja e materialit final të PKZMSA 2010 - 2014 për dërgim në KM.
	15	MIE	Dërgimi i PKZMSA 2010- 2014 për miratim në KM
KM		Miratimi i VKM Nr 577 për "Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 463 datë 5.07.2006 të KM, për miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së	

1b. Monitorimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Janar	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Shkurt	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Shkurt	20	MIE	Raporti dy mujor për Komisionin Evropian
Mars	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Prill	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Prill	20	MIE	Raporti dy mujor për Komisionin Evropian
Maj	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Qershor	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Qershor	20	MIE	Raporti dymujor për Komisionin Evropian
Korrik	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
	20	MIE	Raporti i progresit për Shqipërinë për procesin e stabilizim- asociimit-për periudhën qershor shtator 2010
Gusht	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Shtator	5	MIE	Raporti i përditësuar i Progresit 2010
Tetor	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Nëntor	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së
Dhjetor	4	Institucionet	Raporti mujor për monitorimin e zbatimit të MSA-së

2A. DSHIP dhe finalizimi i IPA 2010

Muaji	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Shkurt	MIE	Dorëzohen në Delegacionin e BE-së projekt-fishat për projektet përfundimtare që do të përfshihen në IPA 2010
Mars	Komisioni Evropian, MIE	Diskutohen në detaje projekt-fishat e IPA 2010 me Misionin Programues të IPA 2010
Prill-Maj	Komisioni Evropian, ML, MIE	Reflektohen sugjerimet/komentet dhe rishikohen në detaje projekt-fishat
Maj-Qershor	Komisioni Evropian	Këshillim brenda Shërbimeve të Komisionit
Shtator	Komisioni Evropian	Komiteti i IPA-s miraton fishat e IPA-s për vitin 2010
Dhjetor	MIE	Fillon procedurat për miratimin e Marrëveshjes Financiare të IPA 2010

2B. Programimi i IPA 2011

Muaji	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Qershor	MIE	Përgatit Kalendarin për Programimin e IPA 2011
Korrik	MIE, Ministrinë e Linjës	Përgatisin analizën sektoriale dhe identifikimin e prioriteteve sipas PKZMSA-së të rishikuar, strategjive sektoriale dhe dokumentave strategjike
Shtator	Ministrinë e Linjës	Përgatisin projekt-propozimet për mbështetje nga IPA 2011
Shtator	MIE, DEBASKON Ministrinë e Linjës	Përfundojnë konsultimet për projekt-propozimet e Ministrive të Linjës
Tetor	KPS	Miraton projekt idetë e IPA 2011
Nëntor	KE, MEI, DEBASKON, ML	Misioni i programimit të IPA, negociohen projektet e miratuara
Dhjetor	ML	Shkrimi i projekt-fishave të IPA 2011

2C. Programimi i Instrumentit të Përgatitjes së Projekteve të Investimit në Infrastrukturë (IPF) për vitin 2010

Muaji	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Janar - Shkurt	Ministritë e Linjës	Përgatisin projekt-propozimet për mbështetje nga IPF
Shkurt	KPS	Miraton projekt idetë për raundin e V-të të IPF-së
Shkurt	MEI	Dërgon zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Zgjerimit propozimet dhe fishat e Shqipërisë
Qershor	Komiteti Drejtues i WBIF	Miraton listën e projekteve për mbështetje në raundin e IV-rt
Qershor - Korrik	Ministritë e Linjës	Përgatisin projekt-propozimet për mbështetje nga IPF
Korrik	KPS	Miraton projekt idetë për raundin e V-të të IPF-së
Korrik	MEI	Dërgon zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Zgjerimit propozimet dhe fishat e Shqipërisë
Dhjetor	Komiteti Drejtues i WBIF	Miraton listën e projekteve për mbështetje në raundin e V-të

2D. Decentralizimi

Muaji	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
janar 2010	MF, KM	Krijimi i Fondit Kombëtar (FK)
deri maj 2010	ML	Rekrutimi i personelit në strukturat e IPA në ML dhe FK, AA (Agjencia e Auditit)
janar-nëntor 2010	CFCU/MF	Raportim dymujor mbi ecurinë DIS në EU : Raporti i parë në mars
prill 2010	Qeveria + AT	Krijimi i rrjetit AFCOS ^[1]
mars-prill 2010	AT	Përgatitja e Raportit mbi GAP assessment (Vlerësimi i vakumit)
maj-vazhdim	AT	GAP plugging (Mbushja e vakumit)
tetor 2010	AT	Raporti i Auditit për draftin "Compliance Assessment" (vlerësimi i përputhshmërisë)
nëntor 2010	CAO-NAO ^[2]	Akreditimi në nivel kombëtar dhe dorëzimi i paketës së akreditimit në KE: aplikimi

3. Përkthimi i "Acquis Communautaire" në gjuhën shqipe

Muaji	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Dhjetor 2009 - Janar 2010	MIE	Përzgjedhja e përkthyesve për përkthimin e Pyetësorit (të cilët do të angazhohen në vijim me përkthimin e acquis)
Janar 2010	MIE	Instalimi i software-it të përkthimit, TRADOS, që do të shërbejë për unifikimin e terminologjisë dhe përshpejtimin e procesit të përkthimit
Janar 2010	MIE	Instalimi i sistemit elektronik të menaxhimit të përgatitjes së versionit shqip të acquis communautaire
Mars 2010	MIE	Përkthimi i përgjigjeve të Pyetësorit të KE-së
Prill-Dhjetor	MIE	Përkthimi "Acquis" sipas prioriteteve

[1] AFCOS-AFCOS-Anti-Fraud[1] Co-ordination Service

[2] Competent Accrediting Officer-National Authorising Officer

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESEM [PBA]

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është elementi thelbësor i Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI). Procesi i përgatitjes së PBA-së udhëhiqet nga Ministria e Financave dhe kërkon nga çdo ministri hartimin e një plani 3-vjeçar brenda një tavani të caktuar shpenzimesh për arritjen e objektivave politike në program si një hap i ndërmjetëm drejt arritjes së qëllimeve dhe objektivave të SKZHI-së dhe strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale.

Proceset dhe produktet kryesore të PBA-së:

1. Vlerësimi dhe parashikimi makroekonomik
2. Përditësimet ekonomike dhe financiare
3. Përgatitja e PBA-së për periudhën 2011-2013 dhe e Buxhetit të Shtetit 2011
 - a. Procesi i hartimit të PBA-së 2011-2013
 - i. Vlerësimi i prioriteteve: Rishikimi i Politikës së Programit (RPP)
 - ii. Vlerësimi i prioriteteve: Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP)
 - b. Vlerësimi i prioriteteve: Buxheti vjetor

Shënim:

- Datat dhe veprimet që lidhen me PBA-në përmenden edhe në pjesë të tjera

KALENDARI PËR PBA-NË DHE BUXHETIN PËR VITIN 2010

Periudha	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi përkatës
Dhjetor 2009		MF	Përgatit dhe paraqet në KPS Kalendarin e MSHP
Dhjetor 2009		KPS/KM	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e MSHP
Dhjetor 2009	30	MF	Paraqet në KPS Raportin mbi Vlerësimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Buxhetore
Janar	6 - 7	KPS/KM	Miraton Raportin mbi Vlerësimet dhe Parashikimet Makroekonomike dhe Buxhetore (R.V.P.M.B). KM miraton R.V.P.M.B
Janar	14	KM	Shqyrton dhe miraton Programin EFP-së
Shkurt	2	MF	Paraqet në KPS tavanet e përgatitjes së PBA-së
Shkurt	5 - 12	KPS	KPS shqyrton tavanet e përgatitjes së PBA-së dhe i miraton ato.
Shkurt	15	KM	Paraqet për informacion R.V.P.M.B dhe Tavanet në Kuvend
Shkurt	22	MF	Dërgon Udhëzimin e Përgatitjes së Buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet e tyre speciale.
Shkurt - Prill	23 Shkurt - 30 Prill	Njësitë e Qeverisjes Qendrore dhe Fondet Speciale të tyre	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore.
Prill	20	MF	Dorëzon për miratim në KPS parashikimin e përditësuar makro
Prill	27-29	KPS/KM	Miraton parashikimin e përditësuar makro
Prill	30	Njësitë e Qeverisjes Qendrore dhe Fondet Speciale të tyre	Paraqesin në MoF kërkesat e tyre buxhetore
Maj	3 - 14	MF, MIE dhe DEBASKON	Kryen analizat e kërkesave buxhetore
Maj	17 - 31	MF, MIE dhe DEBASKON	Organizon seancat dëgjimore me institucionet buxhetore
Qershor	1 - 11	MF	Përgatit dokumentin e PBA-së dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA-së

Periudha	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi përkatës
Qershor	15	MF	Paraqet dokumentin e PBA-së dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA-së për shqyrtim dhe miratim në KPS
Qershor	18 - 30	KPS/KM	Miratton dokumentin e PBA-së dhe tavanet e reja të shpenzimeve të PBA-së
Korrik	10 - 30	KM	I paraqet Kuvendit për informacion vendimin e miratuar të dokumentit të rishikuar të PBA-së
Korrik	9	MF	Dërgon Udhëzimin Plotësues të Përgatitjes së Buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet e tyre speciale.
Korrik - Gusht	13 Korrik - 30 Gusht	Njësitë e Qeverisjes Qendrore dhe Fondet Speciale të tyre	Përgatisin kërkesat e rishikuara buxhetore
Gusht	17	MF	Dorëzon në KPS parashikimin e përditësuar makro
Gusht	20 - 27	KPS/KM	Miratton parashikimin e përditësuar makro
Gusht	31	Njësitë e Qeverisjes Qendrore dhe Fondet Speciale të tyre	Paraqesin në MoF kërkesat e rishikuara buxhetore
Shtator	1 - 15	MF, MIE dhe DEBASKON	Kryen analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator	16 - 30	MF, MIE dhe DEBASKON	Organizon seancat dëgjimore me institucionet buxhetore
Tetor	5	MF	Paraqet në KM parashikimin e përditësuar makro
Tetor	8 - 15	KPS/KM	Miratton parashikimin e përditësuar makro
Tetor	1 - 20	MF	Përgatit dokumentin e rishikuar të PBA-së, Projektbuxhetin Vjetor dhe i paraqet për shqyrtim në KPS-së
Tetor	22 - 28	KPS/KM	Miratton Projektbuxhetin Vjetor dhe dokumentin e rishikuar të PBA-së
Tetor	29	KM	I paraqet Kuvendit Projektbuxhetin Vjetor dhe Dokumentin e Rishikuar të PBA-së

2. Përditësimet ekonomike dhe financiare dhe Raportet

Muaji	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Mars	MF	Vlerësimi Makroekonomik dhe Financiar për vitin 2009
Prill	MF	Përditësimi tremujor Ekonomik dhe Financiar për vitin 2010
Korrik	MF	Përditësimi tremujor Ekonomik dhe Financiar për vitin 2010
Tetor	MF	Përditësimi tremujor Ekonomik dhe Financiar për vitin 2010
Nëntor	MF	Raporti Vjetor Makroekonomik për Komisionin Evropian

NDIHMA E HUAJ

Një bashkërendim më i madh i ndihmës së huaj me përparësitë strategjike kombëtare dhe procesin e planifikimit të buxhetit është objektivi kryesor i Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI). Efikasiteti i menaxhimit të ndihmës ka qenë në fokusin e vëmendjes së Qeverisë dhe donatorëve që operojnë prej vitesh në Shqipëri dhe përpjekjet e përbashkëta në këtë drejtim kanë kaluar nëpër cikle të ndryshme të arkitekturës institucionale dhe përmirësimit të proceseve.

Proceset dhe produktet kryesore që lidhen me ndihmën e huaj

1. Monitorimi i ndihmës së huaj
2. Aktivitetet për koordinimin e donatorëve
3. Monitorimi i zbatimit të Deklaratës së Parisit
4. Iniciativa Fast Track mbi ndarjen e punës (FTI-DoL)

KALENDARI PËR ASISTENCËN E HUAJ PËR VITIN 2010

1. Monitorimi i Ndhmës së Huaj³

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Janar- Mars		DEBASKON	Përditësimi dhe analizimi i të dhënave mbi projektet e donatorëve
Prill		KM	Miratimi i procedurave të reja të menaxhimit të ndihmës së huaj
Mars-Maj		DEBASKON	Konceptimi i procedurave të EAMIS
Qershor-Gusht		DEBASKON	Përditësimi dhe analizimi i të dhënave mbi projektet e donatorëve
Tetor - Dhjetor 2010		DEBASKON	Lançimi i EAMIS

2. Aktivitete për koordinimin e donatorëve

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Veprimi
Janar		DEBASKON	Takimi i grupit mbështetës të SPI-së
		DEBASKON	Hartimi i kalendarit të misionëve programuese dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me donatorët
		DEBASKON DTS	Hartimi i kalendarit të takimeve të Grupeve Sektoriale të Punës 2009-2010 ⁴
Mars		KE DEBASKON	Organizimi i seminarit nga Komisioni Europian me qëllim shkëmbimin e eksperiencave më të mira në përgatitjen e strategjive sektoriale dhe përdorimit efikas të tyre për mbështetje financiare, zhvillimin e metodave të punës për strategjitë sektoriale si dhe vendosjen e standarteve për përcaktimin e prioritetëve, Bosnje-Hercegovinë
Maj		DEBASKON	Takimi i grupit mbështetës të SPI-së
		DEBASKON DTS	Tryeza e rrumbullakët Qeveri - Donatorë
Tetor		DEBASKON	Takimi i grupit mbështetës të SPI-së
		KE DEBASKON	Konferenca Rajonale për Koordinimin e Donatorëve, Bruksel
Nëntor		DEBASKON DTS	Tryeza e rrumbullakët Qeveri - Donatorë

³ Raporti i Progresit të Ndhmës së Huaj, dokument i rëndësishëm i monitorimit të ndihmës, do të jetë pjesë e Raportit të Progresit të SKZHI-së, dhe datat për hartimin e tij janë përcaktuar në kapitullin e SKZHI-së.

⁴ Kalendari i GSP-ve është bashkangjitur si Shtojcë 2

3. Monitorimi i Zbatimit të Deklaratës së Parisit

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Janar-Qershor		DEBASKON DTS	Lançimi i Anketës mbi Monitorimin e Deklaratës së Parisit për 2010
		DEBASKON DTS	Shpërndarja e pyetësorëve të anketës tek donatorët dhe ministrinë e linjës Kryerja e procesit konsultativ për plotësimin e anketës
		DEBASKON	Përgatitja e raportit duke u bazuar në rezultatet e anketës Konsultimi i rezultateve dhe raportit me donatorët dhe ministrinë e linjës
		DEBASKON	Përcjellja e raportit tek OECD/DAC Përgatitja dhe lancimi i raportit përfundimtar
Janar-Mars		DEBASKON	Hartimi i hapave konkretë dhe afateve kohore për të përmirësuar efektivitetin e ndihmës së huaj në kuadër të Planit të Veprimit për Harmonizimin
Janar-Mars		DEBASKON	Vlerësimi i cilësisë së sistemeve të prokurimeve publike përmes aplikimit të metodologjisë së OECD/DAC.
Maj-Qershor		DEBASKON	Rifreskimi i Planit të Veprimit për Harmonizimin bazuar në rezultatet e Anketës 2010 dhe vlerësimin të misionit të prokurimit

4. Iniciativa Fast Track mbi Ndarjen e Punës (FTI-DoL)

Muaji	Data	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Janar		DEBASKON Italy/DTS	Finalizimi i matricës mbi Ndarjen e Punës dhe marrëveshjes së donatorëve evropianë për ndarjen e roleve mes tyre
Shkurt-Mars		DEBASKON Italy/DTS	Hartimi i hapave konkretë dhe afateve kohore për të përmirësuar efektivitetin e ndihmës së huaj në kuadër të iniciativës Fast Track për ndarjen e punës
Prill-Nëntor		DEBASKON Italy/DTS	Zgjerimi i iniciativës për të përfshirë komunitetin e gjerë të donatorëve

KALENDARI PARAPRAK I TAKIMEVE TË KPS PËR VITIN 2010

Synimi kryesor i hartimit të kalendarit të SPI-së është pikërisht hartimi i axhendës paraprake të takimeve të KPS-së, organ i cili miraton proceset kryesore të SPI-së. Kalendari i mëposhtëm është hartuar duke harmonizuar datat e sejcilit proces.

Muaji	Data		Aktiviteti
Janar	6	MF/DEBASKON	Miratimi në KPS i kuadri makroekonomik 2011-2013
Shkurt	6-12	MF/DEBASKON	Shqyrtimi në KPS i Dokumentit mbi Politikat Prioritare që ndikojnë në caktimin e tavaneve Miratimi në KPS i tavaneve të ministrive për PBA 2011-2013 Miratimi në KPS i projekt propozimeve në kuadër të IPF Raundi i IV-rt
Mars	20	DEBASKON/ML/MIE	Listë e projekteve prioritare për financim nga donatorët për miratim në KPS
Prill	27	MF/DEBASKON	Miratimi në KPS i kuadrit të përditësuar makroekonomik, 2011-2013
Qershor	19	MF/DEBASKON	Miratimi në KPS i dokumentit të PBA-së dhe tavaneve të reja të shpenzimeve të PBA -së
Korrik		MIE/DEBASKON	Miraton projekt idetë për raundin e V-të të IPF-së
Gusht	21	MF/DEBASKON	Miratimi në KPS i kuadrit të përditësuar makro dhe diskutimi i çështjeve të buxhetit Paraqitja e projektbuxhetit të shtetit për miratim përfundimtar nga KM
Tetor	9 23	MF/DEBASKON/MIE	Miratimi në KPS i kuadrit të përditësuar makroekonomik Miratimi në KPS i projektbuxhetit vjetor dhe dokumentit të rishikuar të PBA-së Miratimi në KPS i projekt ideve të IPA 2011

BOTIME NË KUADËR TË SPI-së PËR VITIN 2010

Në kuadër të zbatimit të SPI-së dalin në shtyp disa botime që jepen në tabelën më poshtë:

Muaji	Institucioni përgjegjës	Botimi
Shkurt	DEBASKON	Kalendari i SPI-së
Qershor	DEBASKON	Raporti SKZHI-së dhe Ndihmës së Huaj 2009
Prill-Maj	ML	PIM-et 2009 për 14 Ministrinë e Linjës
Çdo muaj	DEBASKON dhe DTS	Botimi informativ i përmuajshëm i "Government-Donor Dialogue"
Shkurt	DEBASKON	Plani i Komunikimit të SPI-së
Tetor	MF	Botimi i projektbuxhetit

SHTOJCA 1: VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I PROCESIVE

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

SKZHI-ja kristalizon vizionin afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të vendit në bazë të një procesi transparent dhe të hapur, i cili garanton përfshirjen e gjerë të shoqërisë civile, të qeverisjes vendore, të komunitetit të biznesit, të botës akademike dhe shkencore, të spektrit politik shqiptar dhe të grupeve të tjera të interesit. Zbatimi i SKZHI-së parashikon ndërtimin e politikës së analizës së kapaciteteve për të siguruar që qëllimet/objektivat e SKZHI-së të përkthehen në mënyrë të efektshme në politika konkrete dhe programe në nivel ministrie.

1. Politikat prioritare

Që në fillim të vitit 2010 fillon procesi i planifikimit në kuadër të Procesit Buxhetor Afatmesëm PBA 2011-2013. DEBASKON luan një rol shumë të rëndësishëm, duke siguruar që prioritetet e politikave të shprehura në strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, të reflektohen në përcaktimin e taveve buxhetore gjatë procesit të PBA-së. Përpara fillimit të procesit të PBA-së, Ministria e Financave dhe DEBASKON përgatisin tre materiale për Komitetin e Planifikimit Strategjik: 1) kuadrin makroekonomik (MF); 2) Dokumentin e Politikave Prioritare 2011-2013 (DEBASKON); 3) Programin Financiar Publik Afatmesëm (MF); 4) kalendarin e SPI-së (MF, MIE, DEBASKON); 5) propozimet për tavanet buxhetore fillestare (MF).

a. Dokumenti i Politikave Prioritare, për t'u përfshirë në PBA 2011- 2013

DEBASKON harton *Dokumentin e Politikave Prioritare* me qëllim që të ndihmojë Komitetin e Planifikimit Strategjik (KPS) në përcaktimin e taveve buxhetore të ministrive dhe dhënien e informacionit për projekte të mundshme dhe për nevoja financiare për PBA 2011-2013. Ky dokument do të bazohet në propozimet e ardhura nga ministrinë dhe do të analizohet nga DEBASKON. Për të ndihmuar ministrinë e linjës do të shpërndahen udhëzime të përgatitura nga DEBASKON, në janar 2010, mbi të cilat ministrinë do të identifikojnë politika të reja apo ekzistuese, që kanë një vlerë të konsiderueshme financiare. Propozimet e ministrive do të paraqiten për diskutim dhe miratim në KPS në muajin shkurt. Aty do të vendoset për prioritetet që do të merren parasysh në përcaktimin e taveve të PBA 2011-2013, të cilët do të miratohen më pas në mbledhjen e KPS-së në muajin shkurt.

2. Plani i Integruar i Ministrisë 2010

Plani i Integruar i Ministrisë (PIM) përmbledh angazhimet kryesore në kuadrin e PBA-së, përfshin të gjitha angazhimet në kuadrin e integritit evropian, legjislacionin e planifikuar, investimet publike madhore, masat e korrupsionit dhe projektet më të rëndësishme të ndihmës së huaj. Plani i Integruar i Ministrisë botohet në tremujorin e parë të vitit 2010 dhe përmbledh si pjesë të rëndësishme të tij:

- a. *Planin e Monitorimit të Ministrisë për vitin 2010, i cili shërben për monitorimin dhe raportimin dhe përbëhet nga një grup objektivash dhe detyrimesh ligjore të rëndësishme. Këto objektiva dhe detyrime ligjore, përcaktohen në bashkëpunim me ministrinë e linjës në muajin shkurt. Monitorimi i tyre do të bëhet çdo vit.*
- b. *Programin e përgjithshëm analitik të projekt-akteve për vitin 2010, i cili është një listë e detajuar e projekt-akteve të parashikuara për t'u propozuar për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për çdo fushë veprimtarie dhe i ndarë në katërmujore. Ecuria e hartimit të projekt-akteve do të monitorohet dy herë në vit.*

3. Raporti Vjetor i Rezultateve të Ministrisë për vitin 2009

Raporti Vjetor i Rezultateve të Ministrisë (RVR) shpreh rezultatet e arritura mbi angazhimet e shprehura në Planet e Integruara të Ministrive të vitit paraardhës, duke përfshirë: raportimin mbi progresin e arritur në lidhje me objektivat e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale të ministrisë përkatëse për vitin 2009; raportimin për programin e projekt-akteve të realizuara për vitin 2009; rezultatet lidhur me integritin evropian për vitin 2009; ecuria lidhur me investimet publike të vitit 2009; ecuria e projekteve të ndihmës së huaj, si edhe realizimi i masave anti-korrupsion për vitin 2009.

4. Raporti Vjetor për Progresin e SKZHI-së 2009

Raporti Vjetor i Progresit të SKZHI-së paraqet ecurinë e arritur kundrejt rreth 45 indikatorësh të nivelit të lartë. Një pjesë e mirë e këtij informacioni grumbullohet nëpërmjet INSTAT-it ose vëzhgimeve të veçanta dhe kërkon vetëm një kontribut nga ana e ministrive. Ky raport përgatitet dhe përfundon në fillim të gjashtëmujorit të parë të vitit 2010. Për vitin 2009, ky raport do të përfshijë edhe raportin e progresit të ndihmës së huaj.

5. Monitorimi i Strategjive Sektoriale dhe Ndërsektoriale

Zbatim efektiv i SKZHI-së kërkon përmirësimin e sistemit të monitorimit, ku ministritë të raportojnë rregullisht në lidhje me progresin e bërë kundrejt objektivave kyç dhe rezultateve të përcaktuara në SKZHI dhe strategjitë sektoriale të cilat zërthehen më pas në rezultate të PBA-së. DEBASKON do të iniciojë procesin e monitorimit lidhur me zbatimin e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale duke filluar me rishikimin e treguesve të përcaktuar në këto strategji, të cilat do të përkthehen më pas në masa konkrete në kuadër të PBA-së. Në procesin e rishikimit të treguesve është parashikuar gjithashtu përfshirja e Grupeve Këshillimore të SKZHI-së dhe shoqërisë civile me qëllim kryerjen e një dialogu të frutshëm për politikën e vendit i orientuar drejt rezultateve.

6. Procesi i Vlerësimit të Ndikimit të Politikave (VNP)

Vlerësimi i Ndikimit të Politikave është një proces që kryhet përpara hartimit të një politike dhe të një kuadri ligjor, duke identifikuar paraprakisht ndikimin e politikave (financiar, ekonomik, social, institucional, etj). Ky proces u jep vendimmarrësve më shumë mundësi zgjedhjeje në lidhje me politikën që do të ndërmerren. Vlerësimi i Ndikimit të Politikave mund të përfshijë disa aspekte, sipas rëndësisë së politikës që mendohet të ndërmerret: (i) Vlerësimin e Ndikimit Fiskal (VNF), i cili analizon kostot disa-vjeçare të zbatimit të një projektligji dhe identifikon ndikimet financiare mbi ministritë e linjës apo nivelet e ndryshme të qeverisë; (ii) Vlerësimin e Ndikimit Rregullator (VNR) që analizon ndikimet financiare dhe administrative që do të kenë bizneset si pasojë e aplikimit të një rregulloreje të re ose të ndonjë ndryshimi në të. Këto procese kërkojnë shpesh që të konsultohen dhe të vlerësohen mendimet e të gjitha palëve të interesuara para se politikën/ligjet të miratohen. Të gjitha vlerësimet e ndikimit të politikave duhet të marrin gjithashtu në konsideratë kërkesat dhe angazhimet e lidhura me çështje të integritetit evropian. Produkt i procesit të vlerësimit të ndikimit të politikave është një dokument, që përmban një përmbledhje të shkurtër të çështjeve për vendimmarrësit. Në rastet kur parashikohet që politika/ligji të jetë prioritar dhe me ndikim të madh atëherë përgatiten edhe analiza financiare, institucionale, etj të detajuara, si një shtojcë e përmbledhjes së sipërpërmendur. Procesi i vlerësimit të ndikimit do të zhvillohet si pjesë e kuadrit të përgjithshëm institucional dhe do të kërkojë rishikimin e nënaktve ligjore të rëndësishme për procesin e VNP-së.

Integrimi Evropian

Pas përmbushjes së procesit të ratifikimit të MSA-së nga të gjithë vendet anëtare, u bë dorëzimi i aplikimit për statusin e vendit kandidat në Bashkimin Evropian, nga autoritetet shqiptare dhe brenda Marsit 2010 parashikohet të dorëzohet i plotësuar Pyetësi i Komisionit Evropian prej 35 kapitujsh.

Një hallkë tjetër që lidhet me Integrimin Evropian është edhe përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së. Pë këtë qëllim gjatë vitit 2009, në Ministrinë e Integritetit u ngrit dhe po funksionon Drejtoria e Përkthimit të Legjislacionit Evropian. Prioritetet e përkthimit vendosen nga Ministria e Integritetit në bashkëpunim me ministritë e interesuara.

1. Zbatimi i MSA-së

a. Vlerësimi i zbatimit të Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së

Ministria e Integritetit Evropian do të drejtojë procesin e rishikimit të Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së, bazuar në raportin e progresit të KE-së të nëntorit 2009. Këtë vit parashikohet gjithashtu edhe një rivlerësim i plotë i planit nga pikëpamja e formës dhe përmbajtjes, për të siguruar një lexueshmëri më të lartë dhe për të pasqyruar metodat e reja të raportimit

elektronik. Gjatë këtij rishikimi një vëmendje e veçantë do t'u kushtohet aspekteve që lidhen me hyrjen në fuqi të MSA-së. Paralelisht, Ministria e Integritit do të koordinojë procesin e përgatitjes së përgjigjeve të pyetësorit të Komisionit Evropian me të gjithë institucionet shqiptare dhe pritjet ta dorëzojë atë brenda muajit mars 2010.

b. Reflektimi i prioriteteve të Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së në PBA

Gjatë ciklit të planifikimit buxhetor, ministritë e linjës duhet t'i kushtojnë një rëndësi të veçantë sigurimit të një lidhjeje organike midis prioriteteve të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së dhe Procesit Buxhetor Afatmesëm. Për këtë arsye, kalendari i rishikimit të planit duhet të rakordohet me atë të përgatitjes së PBA-së.

c. Monitorimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së

Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së do të vazhdojë të monitorohet rregullisht çdo muaj gjatë vitit 2010, si nëpërmjet sistemit "on line" ashtu dhe raportimeve periodike. Komisionit Evropian do t'i dorëzohen raporte periodike si dhe kontributet për Progres Raportin vjetor, i pari në mes të muajit qershor 2010 dhe kontributi i dytë në fillim të muajit tetor 2010. Disa të dhëna të raportimit mund të ndryshohen për t'iu përshtatur ritmit të kërkesave që vijnë nga Komisioni Evropian. Gjithashtu raportimi bëhet dhe në kuadër të takimeve të përbashkëta BE - Shqipëri, në kuadër të Këshillit të Stabilizim Asociimit, Komitetit të Stabilizim Asociimit apo 7 nënkomiteteve, të cilat monitorojnë zbatueshmërinë e MSA-së, që do mbahen gjatë vitit 2010.

d. Analiza e Dokumentit të Partneritetit Evropian dhe Raporti Vjetor i Progresit

Në nëntor 2009, Komisioni Evropian prezantoi Raportin Vjetor të Progresit gjatë procesit të Stabilizim-Asociimit. Qeveria do të vendosë për rishikimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së duke marrë parasysh rekomandimet dhe përparësitë e përcaktuara në këtë raport vjetor.

e. Forcimi i strukturave të përbashkëta BE-Shqipëri të krijuara me hyrjen në fuqi të MSA-së

Me hyrjen në fuqi të MSA-së janë ngritur strukturat e përbashkëta BE-Shqipëri, që mbikëqyrin zbatimin dhe realizimin e Marrëveshjes kjo e përcaktuar në nenet 116, 120 dhe 121 të MSA-së. Në këtë kuadër janë ngritur Këshilli i Stabilizim-Asociimit, Komiteti i Stabilizim-Asociimit si dhe nënkomitetet KE-Shqipëri. Viti 2010 do të shërbejë për forcimin e këtyre strukturave. Gjatë vitit 2009, njësitë e integritit evropian në ministritë e linjës u ngritën në nivel drejtorie për t'ju përshtatur më mirë stadi të progresit të marrëdhënieve BE-Shqipëri me fillimin e procesit të aplikimit për statusin e vendit kandidat dhe më pas zhvillimit të negociatave për çdo kapitull.

2. Instrumenti i Para-aderimit (IPA)

Programi CARDS mbetet në fazën e zbatimit të projekteve dhe nuk kërkon më ndonjë veprimtari programuese. Planifikimi dhe programimi në lidhje me asistencën e BE-së tani bëhet vetëm për Instrumentin e Para-zgjerimit (IPA).

a. Finalizimi i programit IPA 2009

Pas diskutimit dhe miratimit nga Komiteti IPA i Komisionit Evropian të paketës së projekteve në kuadër të Programit IPA 2009, gjatë tremujorit të parë 2010 pritjet nënshkrimi i marrëveshjes financiare, e cila do t'i hapë rrugë zbatimit të projekteve të përfshira në këtë program.

b. Programimi i IPA-s për vitin 2010 dhe fillimi i programit të IPA 2011

Procesi i planifikimit për IPA 2010 ka filluar në muajin korrik 2009, brenda muajit janar 2010 paketa e projekt fishave për IPA 2010 do të jetë përgatitur nga institucionet shqiptare. Kjo paketë do të konsultohet në vijim me shërbimet e Delegacionit të BE-së në Tiranë, për komente dhe sugjerime. me qëllim reflektimin e të gjitha komenteve/sugjerimeve. Më tej, paketa finale do t'i përcillet për miratim Komisionit Evropian në Bruksel sipas procedurave përkatëse. Në muajin korrik 2010 fillon procesi i programimit të IPA 2011.

c. Programimi i Instrumentit të Përgatitjes së Projekteve të Investimit në Infrastrukturë (IPF) për vitin 2010

Në mbështetje të programimit IPA kombëtare, instrumenti financiar i Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) me aktorë kryesorë KE, BEI, BERZH dhe CEB, krijon burime financimi të përbashkëta me kontribut të Komisionit Evropian, partnerëve ndërkombëtarë financiarë, shteteve anëtare dhe donatorë të tjerë. Gjatë muajit janar 2010, Ministritë e Linjës do të

përgatisin propozime me qëllim financimin e projekteve prioritare në sektorët e transportit, energjisë, mjedisit, sektorët socialë, SME-të, eficienta e energjisë, sektori financiar. Pas miratimit të paketës së IPF-së për t'u përcjellë në raundin e IV-t nga KPS, Ministria e Integritit në cilësinë e NIPAC do t'i përcjellë pranë Komisionit Evropian në shkurt 2010. Autoriteti që do të përzgjedhë dhe miratojë projektet e Raundit të IV-t të IPF-së është Komiteti Drejtues i WBIF dhe kjo do të bëhet gjatë muajit qershor 2010. Gjithashtu, në qershor 2010 Ministritë e Linjës pritet të fillojnë përgatitjen e projekt-propozimeve për raundin e V-të të IPF-së. Pas miratimit të paketës së IPF-së raundi i V-të në KPS, NIPAC përcjell zyrtarisht listën e projekt propozimeve në fund të muajit korrik 2010, me qëllim miratimin në vijimësi gjatë muajit dhjetor 2010 nga Komiteti Drejtues i WBIF.

d. *Decentralizimi*

Sipas planit për decentralizimin të riparë dhe miratuar (korrik 2009) për ngritjen e sistemit të menaxhimit të decentralizuar (DIS) për IPA komponent I, parashikohet:

- I. Të përfundojë krijimi i strukturave, dhe ngritja e kapaciteve të nevojshme në to (përfshirë manualët e procedurave dhe trajnimin e stafit përkatës) brenda muajit korrik 2010. Institucionet e përfshira në DIS janë: Zyra e NIPAC, përgjegjës për programimin dhe monitorimin e fondeve të IPA komponenti I, Ministria e Financave (Fondi kombëtar (KF)) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve (NjQFK) si dhe ML/SPO(Zyrtarëve të Programimit Sektorial), Agjensia e Auditit të fondeve të BE-së (AA), Auditit i Brendshëm;
- II. Në përputhje me kërkesën e Komisionit Evropian mbi masat që duhet të ndërmerren në luftën kundër korrupsionit dhe parregullsive, nga çdo vend përfitues i fondeve të asistencës komunitare të Bashkimit Evropian, kërkohet ngritja e një shërbimi operacional të pavarur për koordinimin kundër-korrupsionit (AFCOS)⁵, i cili parashikohet të ngrihet gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2010. Ky shërbim do të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjithë aspekteve ligjore, administrative dhe operacionale për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së, dhe të jetë i aftë të bashkëpunojë me OLAF.⁶
- III. Të zbatohen faza e parë "Gap Assessment" (vlerësimi i vakumit) dhe faza e dytë "Gap plugging" (Mbushja e vakumit) lidhur me përgatitjen e sistemit të DIS në Shqipëri gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2010, ndërsa kontraktimi dhe implementimi për fazën III (Compliance Assessment) (vlerësimi i përputhshmërisë) parashikohet të përfundojë në tetor 2010. Një aktivitet i rëndësishëm që parashikohet gjatë vitit 2010 është përgatitja e paketës së akreditimit dhe dorëzimi i aplikimit në Komisionin Evropian në fund të vitit 2010.

3. Përkthimi i "acquis communautaire" në gjuhën shqipe

Një komponent i rëndësishëm i procesit të Stabilizim-Asociimit drejt anëtarësimit të plotë është përkthimi i legjislacionit evropian - "acquis communautaire" në gjuhën shqipe. Për këtë qëllim, në zbatim të VKM nr.119/2007 për "Procedurat e përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe dhe legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit Evropian" është ngritur dhe funksionon pranë Ministrisë së Integritit, Drejtoria e Përkthimit të Legjislacionit Evropian, e cila është struktura e vetme qendrore, që nëpërmjet kontraktimit të përkthyesve të licensuar kryen përkthimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe dhe përkthimin e legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit Evropian si dhe çertifikon legjislacionin e përkthyer më parë ose atë që do të përkthehet nga Ministritë ose institucionet e tjera qendrore. Gjatë vitit 2009 doli VKM nr.1193 datë 3.12.2009 "Për procedurat e përkthimit të Pyetësorit të KE-së në kuadër të anëtarësimit të RSH-së në BE" që përcakton MIE koordinatorë të këtij procesi. Në bazë të sa më sipër është kryer përzgjedhja e përkthyesve (të cilët do të angazhohen me përkthimin e acquis më pas) dhe janë bërë përgatitjet për instalimin e software-it Trados. Është instaluar gjithashtu sistemi elektronik i menaxhimit të procesit të përkthimit të acquis. Prioritetet e përkthimit do të caktohen në bashkëpunim me ministritë përkatëse në vijim të konsultimeve të rregullta me Komisionin Evropian.

⁵ AFCOS- Anti-Fraud[1] Co-ordination Service Fraudulent practise nënkupton një paraqitje të gabuar të fakteve me qëllim që të influencojë një proces përzgjedhjeje ose ekzekutimin e një kontrate.

⁶ European Anti-Fraud Office- Zyra Europiane Kundër-Korrupsionit

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA)

Qëllimi i PBA-së është të sigurohet një lidhje e qartë mes shpërndarjes së buxhetit dhe objektivave politike në program, duke arritur parashikueshmëri dhe efikasitet më të lartë në shpërndarjen e burimeve. Hartimi i këtij dokumenti kalon nëpër etapat e mëposhtme:

1. Vlerësimi dhe parashikimi makroekonomik

Analiza dhe parashikimi makroekonomik për periudhën 2010-2013 përgatitet në fillim të vitit me qëllim që të ofrohet informacioni për përcaktimin e përparësive strategjike, shpenzimeve agregate, synimeve në lidhje me të ardhurat dhe defiçitin, si dhe tavanëve për përgatitjen e PBA-së në nivel ministrie. Parashikimi fillestar përgatitet gjatë muajit dhjetor dhe finalizohet në fillim të muajit janar. Vlerësimi dhe parashikimi përditësohen në dy momente kyç gjatë vitit: në muajin prill, përpara finalizimit të PBA-së dhe të tavanëve të PBA-së për shpenzimet, dhe në muajin gusht, përpara se të dërgohet në Parlament projektbuxheti i shtetit.

2. Përditësimet Ekonomike dhe Financiare dhe Raportet

Çdo tre muaj do të botohen përditësimet përsa i përket ecurisë ekonomike dhe financiare të vendit. Përveç kësaj, vlerësimi i fundvitit do të mbarojë përpara fundit të tremujorit të parë. Një raport vjetor i paraqitet Komisionit Evropian përpara fundit të muajit nëntor.

3. Përgatitja e PBA-së për periudhën 2011-2013 dhe e Buxhetit të Shtetit 2011

PBA-ja e parë që përfshinte të gjitha ministritë u realizua si proces në vitin 2006. PBA-ja/buxheti për periudhën 2007-2009 u finalizua dhe u paraqit për informacion në parlament bashkë me buxhetin e shtetit. Këto hapa janë ndjekur edhe në vitet në vazhdim. Fazat kyçe të PBA-së 2011-2013 miratuar me VKM nr 4 të datës 7.01.2010, që do të zhvillohen në vitin 2010, janë si më poshtë:

a. Vlerësimi i prioriteteve: Rishikimi i Politikës së Programit (RPP)

Në kuadrin e procesit të PBA-së, çdo ministri përgatit deklaratat për politikën e programeve të saj buxhetore, të cilat shqyrtohen dhe rishikohen brenda ministrisë. Ky rishikim kryhet gjatë muajit mars, pas caktimit të tavanëve për çdo ministri linje, në kuadër të përgatitjes së PBA-së 2011-2013. Rishikimi i politikave të programeve përcakton shpenzimet e detajuara për secilin program si dhe projektet e investimeve, dhe bën të mundur që ministritë të hartojnë buxhetet indikative të programeve. DEBASKON në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Integritimit do të bashkërendojë procesin e RPP-së. Qëllimi i RPP-ve është që synimet dhe objektivat e shprehura në SKZHI, në strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, si dhe në MSA të reflektohen sa më mirë në kërkesat për shpenzime të ministrive të shprehura në PBA.

b. Vlerësimi i prioriteteve: Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP)

Gjatë periudhës maj - qershor, ministritë e linjës paraqesin në Ministrinë e Financave, në kuadrin e PBA-së, Planifikimin e Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP). Këto parashikime rishikohen më pas nga Ministria e Financave, DEBASKON dhe Ministria e Integritimit Evropian, dhe prezantohen për diskutim në negociatat që zhvillohen më ministritë e linjës. DEBASKON dhe Ministria e Integritimit do të jenë pjesë e këtyre negociatave dhe do të fokusohen në realizimin e objektivave të strategjive sektoriale dhe angazhimeve të MSA-së, nëpërmjet procesit të PSHIP-it. Mbi bazën e këtyre negociatave të zhvilluara, Ministria e Financave përgatit një draft të PBA-së 2011-2013, të cilin e paraqet për diskutim dhe miratim në KPS.

c. Vlerësimi i prioriteteve: buxheti vjetor 2011

Nëse ka ndryshime të konsiderueshme, DEBASKON do të bëjë një vlerësim për të matur impaktin e këtyre ndryshimeve në zbatimin e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale. Gjatë muajit qershor, KM do të shqyrtojë dhe miratojë draftin e parë të PBA-së dhe tavanet e PBA-së për shpenzimet. Gjatë muajit tetor do të shqyrtohet dhe miratohet drafti i dytë i PBA-së si dhe projektbuxheti vjetor.

Ndihma e huaj

Pronësia dhe roli i qeverisë në koordinimin e ndihmës së huaj ka ardhur duke u rritur gjatë këtyre viteve. Qeveria shqiptare është e angazhuar të udhëheqë përparimin drejt veprimeve prioritare duke marrë parasysh rekomandimet e raportit analitik 2008 mbi Monitorimin, Deklaratën e Parisit dhe Agjendën e Accra-s për Veprim. Planit i Veprimit për Harmonizim i përgatitur nga DEBASKON-i dhe nga Sekretariati Teknik i Donatorëve (STD) është një hap konkret në arritjen e objektivave të

Deklaratës së Parisit dhe dëshmi e bashkëpunimit të mirë të strukturave qeveri-donatorë. Efikasiteti i ndihmës së huaj matet dhe ndihmohet nëpërmjet proceseve të mëposhtme.

1. Monitorimi i Ndhmës së Huaj

Në prill 2008 u lançua Dokumenti për Orientimin e Ndhmës së Huaj, i cili përmbledh përparësitë afatmesme të qeverisë për t'u siguruar që ndihma e huaj përforcon arritjen e qëllimeve të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale. Në vitin 2009 është bërë monitorimi i ndihmës së huaj nëpërmjet përditësimit dhe analizimit të të dhënave mbi programet dhe projektet e donatorëve. Në muajin tetor 2009 është publikuar Raporti i Progresit për Ndhmën e Huaj, i cili është përgatitur nga DEBASKON. Si burim parësor të dhënash ka shërbyer baza e të dhënave e donatorëve, e administruar nga DEBASKON-i, ndërsa burimet dytësore përfshijnë bazën e të dhënave të OECD/DAC, DONH, SKZHI dhe rezultatet e Anketimit për monitorimin e Deklaratës së Parisit të vitit 2008.

Në vitin 2010 do të bëhet monitorimi i ndihmës së huaj nëpërmjet përditësimit dhe analizimit të të dhënave mbi programet dhe projektet e donatorëve si dhe hartimi i Raport Progresit të Ndhmës së Huaj. Raporti i Progresit të Ndhmës së Huaj do të jetë pjesë përbërëse e Raportit të Progresit të SKZHI dhe do të publikohet si një kapitull i veçantë i këtij raporti. Gjithashtu në 2010 do të rishikohen procedurat e menaxhimit të ndihmës së huaj, të cilat do të përfshijnë udhëzime rreth roleve dhe përgjegjësisve të institucioneve qendrore të qeverisë (DEBASKON, MF, MIE, etj.) përsa i përket koordinimit të ndihmës së huaj. Këto do t'i hapin rrugë dizenjimit dhe më pas lançimit të EAMIS (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Ndhmën e Huaj). EAMIS do të mundësojë menaxhimin strategjik të ndihmës së huaj duke përcaktuar prioritetet dhe mbështjetjen nga donatorët, duke përfshirë përgatitjen e raporteve, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve, vlerësimin e ndihmës së huaj në tërësi, etj.

2. Aktivitetet për Koordinimin e donatorëve

Koordinimi i donatorëve do të vazhdojë të bëhet nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme si Tryezat e Rrumbullakëta Qeveri-Donatorë, Grupet Sektoriale të Punës me donatorët, misione të ndryshme, negociata dypalëshe, dhe programe speciale. Do të vazhdojë bashkëpunimi me Sekretariatën Teknik të Donatorëve dhe Grupin Mbështetës të SPI-së. Datat e tryezave të rrumbullakëta që do të zhvillohen gjatë vitit janë përfshirë në kalendarin përkatës. Në fillim të vitit 2010 hartohet kalendar i misioneve programuese/negociuese të donatorëve si edhe kalendar i takimeve të Grupeve Sektoriale të Punës me donatorët që i bashkëngjitet Kalendarit të SPI-së.

3. Monitorimi i zbatimit të Deklaratës së Parisit

Në zbatim të angazhimeve kundrejt Deklaratës së Parisit, në bashkëpunim me Sekretariatën Teknik të Donatorëve në muajin nëntor 2009 është finalizuar Plani i Veprimit të Harmonizuar, në të cilin përcaktohen veprimet për t'u ndjekur gjatë vitit në vijim, nga qeveria dhe donatorët për të përmirësuar efektivitetin e ndihmës së huaj. Ecuria e të 12 treguesve të Deklaratës së Parisit do të matet përmes Anketës 2010, lançimi i së cilës do të bëhet nga OECD/DAC gjatë tremujorit të parë të 2010. DEBASKON dhe Ministria e Financave janë koordinatorët kombëtarë në menaxhimin e anketës, ndërsa Sekretariati Teknik i Donatorëve shërben si pikë kontakti për donatorët.

Promovimi i përdorimit të sistemeve kombëtare të prokurimit nga donatorët është gjithashtu i rëndësishëm për efektivitetin e ndihmës së huaj. Një nga hapat më konkretë të Planit të Veprimit për Harmonizim lidhet me prokurimet publike dhe aplikimin e metodologjisë së OECD/DAC për vlerësimin e cilësisë së tyre. Gjatë periudhës maj-qershor 2009 Metodologjia e Vlerësimit të OECD/DAC iu prezantua aktorëve kryesorë. Vlerësimi aktual është parashikuar të zhvillohet në periudhën janar-mars 2010.

4. Iniciativa Fast Track mbi Ndarjen e Punës (FTI-DoL)

Iniciativa Fast Track për Ndarjen e Punës, është një iniciativë e Komisionit Evropian, e cila synon të mbështesë zbatimin gradual të Kodit të Sjelljes së BE-së në Shqipëri. Italia është përzgjedhur si donatori ndimues për vënien në jetë të kësaj iniciative. Kjo të integrohet me strukturat ekzistuese të koordinimit të donatorëve (kryesisht Grupet Sektoriale të Punës), e kryesuar nga Qeveria Shqiptare veçanërisht në ato sektorë të cilat kanë të bëjnë me axhendën e Integritimit Evropian.

SHTOJCA 2: KALENDARI I TAKIMEVE TË GSP-ve

Kalendar i Takimeve të Grupeve Sektoriale të Punës (GSP)

Riparë: Janar 2010

Legjenda:

Takime të kryera

Të planifikuara

Nr.	Ndarja e Prioriteteve Strategjike (bazuar në SKZHI)	Grupet Sektoriale të Punës (GSP)	2009												2010												
			Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
1	Infrastruktura	Energji									30/0 9				4 (Jav a)		4 (Jav a)		4 (Jav a)	4 (Jav a)			4 (Jav a)				
		Transport														3 (Jav a)	3 (Jav a)			3 (Jav a)				3 (Jav a)			
		Uji				30/0 4								15/1 2				2 (Jav a)				4 (Jav a)		1 (Jav a)			2 (Jav a)
		Mjedisi					12/0 5							25/1 1			1 (Jav a)					1 (Jav a)			2 (Jav a)		
2	Ekonomia dhe Financat	Ekonomia (Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme & Sektori Privat - Teknologjia e Cilësisë dhe Tregu I Brendshëm)		20/0 2 NV M									15/1 0 NV M				2 (Jav a)					1 (Jav a)			2 (Jav a)		
		Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi																							2 (Jav a)		2 (Jav a)
		Statistika		16/0 2												21/0 1					3 (Jav a)					1 (Jav a)	
		Financat Publike																2 (Jav a)					4 (Jav a)			1 (Jav a)	

Kalendari i Sistemit të Planifikimit të Integruar për vitin 2010

Nr.	Ndarja e Prioriteteve Strategjike (bazuar në SKZHI)	Grupet Sektorial të Punës (GSP)	2009												2010											
			Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
3	Zhvillimi Shoqëror	Sigurimet Shoqërore															2 (Jav a)			4 (Jav a)				1 (Jav a)		
		Mbrojta dhe Përfshirja Sociale			18/03												2 (Jav a)				1 (Jav a)					2 (Jav a)
		Punësimi, Migracioni dhe Formimi Profesional		05/02 (Formimi Profesional)	18/03												2 (Jav a)			1 (Jav a)						1 (Jav a)
		Barazia Gjinore dhe Dhuna në Familje				22/04							29/10				26/02				3 (Jav a)					3 (Jav a)
		Arsimi (jo i përfshirë formimi profesional)					09/05							03/11					1 (Jav a)							3 (Jav a)
		Shëndetësia			05/03				12/06					26/11				4 (Jav a)				1 (Jav a)			4 (Jav a)	
		Rinia dhe Kultura																4 (Jav a)				1 (Jav a)				1 (Jav a)

Kalendari i Sistemit të Planifikimit të Integruar për vitin 2010

Nr.	Ndarja e Prioriteteve Strategjike (bazuar në SKZHI)	Grupet Sektorial të Punës (GSP)	2009												2010													
			Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor		
4a	Drejtësia dhe Cështjet e Brendshme Konsorciumi Ndërkombëtar	Drejtësia: Reforma Ligjore (përfshirë: Drejtësia e të Miturve & Reforma e Burgeve)	29/01 DM & RB			Takimi Plenar 28/04					14/09 RL 17/09 DM 30/09 RB			14/12 RL														
		Mbrojtja e Dëshmitarëve	28/01						08/07																			
		Policia e Shtetit (Policia dhe Krimi I Organizuar)												23/11														
		Policia në Komunitet dhe Parandalimi I Krimin		27/02								13/08			24/11													
		Menaxhimi I Integruar I Kufijve dhe Migracioni								19/06							04/02											
		Trajnimi dhe Asistencë me bazë materiale	27/01								09/06				28/10													
		Menaxhimi I Informacionit dhe Teknologjia															21/01											

Kalendari i Sistemit të Planifikimit të Integruar për vitin 2010

Nr.	Ndarja e Prioriteteve Strategjike (bazuar në SKZHI)	Grupet Sektorial të Punës (GSP)	2009												2010											
			Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
4b	Drejtësia dhe Cështjet e Brendshme	E Drejta e Pronës															3 (Jav a)					3 (Jav a)			1 (Jav a)	
		Anti Korrupsioni										15/10 (ML Str.)					4 (Jav a)							3 (Jav a)		3 (Jav a)
		Administrata Publike																1 (Jav a)						3 (Jav a)		
		Media dhe Shoqëria Civile										15/10 Don or only					3 (Jav a)							4 (Jav a)		4 (Jav a)
		Zgjidhjet dhe Regjistri Civil																1 (Jav a)						1 (Jav a)		
5	Zhvillimi Urban, Rural dhe Rajonal.	Decentralizimi dhe Zhvillimi Rajonal														3 (Jav a)									4 (Jav a)	
		Bujqësia, Ushqimi dhe Zhvillimi Rural																1 (Java)							2 (Jav a)	
		Turizmi															2 (Jav a)			4 (Jav a)					3 (Jav a)	
		Planifikimi I territorit dhe Strehimi															3 (Jav a)								3 (Jav a)	

